



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANË – BASIC COURT OF GJILAN

AD.GJTH.GJL.nr.1/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtorin profesional Faton Lakna, duke vepruar sipas ankesës së parashtuar nga ankuesi G. M. avokat nga Kamenica, të datës 23.12.2022, për iniciimin e procedurës disiplinore, ndaj gjyqtarit A. A. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, me datë 24.01.2023, morri këtë:

AKTVENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e G. M., avokat nga Kamenica, e datës 23.12.2022, për iniciimin e procedurës disiplinore konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të paraqitur ndaj gjyqtarit A. A. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë.

Arsyetimi

Me datë 23.12.2022, ankuesi G. M. avokat nga Kamenica, pranë Këshillit Gjyqësorë të Kosovës ka paraqitur ankesë, kurse Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datën 29.12.2022, ankesën e lartëcekur e ka kthyer tek autoriteti kompetent i kësaj gjykate, për veprime të mëtutjeshme, lidhur me pretendimet e ankuesit për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A. A. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, nën arsyetimin se sjelljet e gjyqtarit gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore në lëndën C.nr.81/2018, kanë qenë tendencioze dhe sjelljet e tilla bien ndesh me profesionalizimin dhe etikën e gjyqtarit.

I njejtë tutje ka theksuar se në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë është në trajtim e sipër lënda kontestimore C.nr.81/2018, në të cilën çështje palët kan dhënë fjalën përfundimtare dhe se tani jemi në pritje të vendimit të gjykatës, mirëpo gjatë zhvillimit të kësaj

procedure gjyqtari i lartëcekur më dt.08.11.2022, ka marrë aktvendim dhe ka vendosur që në seancën e radhës të ftohet në cilësinë e dëshmitarit inspektori i arsimit në kuadër të SIA në Gjiilan, me qëllim që i njejt i sqaroj disa rrethana të rëndësishme lidhur me një raport të përpiluar nga vet ky inspektor, mirëpo që gjyqtari i çështjes në seancën e dt.20.12.2022, edhe për kundër faktit se ky dëshmitarë nuk është ftuar në mënyrë të rregullt, merë aktvendim dhe e revokon pikën I të dispozitivit të aktvendimit procedural të dt.08.11.2022, kështu që me anë të këtij aktvendimi vendos që të mos dëgjohet dëshmitari i lartëcekur, nga se sipas gjyqtarit dëgjimi i këtij dëshmitari është i panevojshëm.

Andaj i njejt përmes kësaj ankese të drejtuar Këshillit Gjyqësorë të Kosovës ka shprehur shqetësim dhe paknaqësi lidhur me trajtimin e rastit në fjalë nga Gjyqtari A [REDACTED] A [REDACTED], duke kërkuar që për këtë çështje të inicohet procedurë për shkelje të mundshme disiplinore ndaj gjyqtarit të lartëcekur.

Kryetari i gjykatës, pas pranimit të ankesës nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të paraqitur nga pala ankuese dhe analizimit të pretendimeve të të njejt në ankesën e tij, ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë më ndonjë shkelje të mundshme disiplinore dhe se lidhur me këtë çështje nuk ka kërkuar nga gjyqtari që të deklarohet rreth pretendimeve të palës ankuese, nga se sipas vlerësimit të kryetarit të kësaj gjykate ankesa e palës ankuese e dt. 23.12.2022, është e pabazuar dhe se pretendimet e të njejt nuk e justifikojnë iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit në fjalë.

Deri te një përfundim i tillë kryetari i gjykatës erdhi pas vlerësimit dhe analizimit me shumë kujdes të pretendimeve të palës ankuse të paraqitura në ankesën e tij, ku sipas kryetarit të kësaj gjykate veprimet e gjyqtarit A [REDACTED] A [REDACTED] gjat zbatimit të procedurës kontestimore lidhur me revokimin e aktvendimit për marrjen e provës me anë të dëgjimit të dëshmitarit në fjalë, nuk mund të konsiderohen si veprime tendencioze, joprofesionale dhe që janë në kundërshtim me etikën e gjyqtarit dhe si të tilla nuk mund të cilësohen si shkelje disiplinore nga ana e të njejt, nga se gjyqtari mandatin e tij e tij gjyqësorë e ushtron në mënyrë të pavarur dhe profesionale, duke i vlerësuar në mënyrë individuale të gjitha faktet dhe provat që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm dhe në mënyrë meritore, andaj edhe në rastin konkret sipas dispozitave të LPK-së, është në kompetencën e gjyqtarit që ai të vlerësojë vetë se cilat fakte duhet të provohen dhe se cilat prova duhet të merrën me qëllim të vërtetimit të fakteve të tilla për vendosje në mënyrë meritore në një çështje juridike kontestimore.

Andaj kryetari i kësaj gjykate vlerëson se gjyqtari i çështjes gjat zbatimit të procedurës kontestimore ka vepruar në mënyrë të drejtë, sipas vlerësimit të tij profesional, mbrenda kompetencave dhe në përputhshmëri me autorizimet që ka sipas dispozitave të LPK-së, ashtu që në rastin konkret me veprimet procedurale që i ka ndërmar gjyqtari mbrenda kompetencave të tij nuk mund të konsiderojmë se kemi të bëjmë me ndonjë veprim tendencioz, joprofessional apo

ndonjë shkelje të etikës së gjyqtarit, andaj edhe konform nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, kryetari i kësaj gjykate ka gjetur se ankesa e av.G [REDACTED] M [REDACTED], e dt.23.12.2022, është e pabazuar dhe për të njejtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetari i Gjykatës

Vënhar Salihu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Gjyqtarit A [REDACTED] A [REDACTED],
2. Parashtruesit të ankesës,
3. KGJK-së
4. Dosjës së lëndës.